

PKR.nr.227/14

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA, në përbërje nga gjyqtarja Valbona Musliu-Selimaj, Kryetare e trupit gjykues dhe gjyqtarëve profesionist Faik Hoxha dhe Nora Bllaca-Dula, anëtarë të tupit gjykues, me pjesëmarrjen e sekretares juridike, Arbnore Idrizi, punëtore e kësaj gjykate, në çështjen penale, kundër të akuzuarëve: N .E., për shkak të veprës penale, Prodhimi dhe shpërndarja e produkteve të dëmshme mjekësore, nga neni 266 par.2 të KPRK-së dhe E. S, për shkak të veprës penale, Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par.1 të KPK-së, të akuzuar sipas Aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë, Departamenti për Krime të Rënda, PP.I.nr.1289/2013, të datës 25.04.2014, pas mbajtës së seancave të shqyrtimit gjyqësor të hapura, verbale të mbajtura me datat **11.03.2016, 25.04.2016, 29.06.2016** dhe të vazhduar me datën **28.07.2016**, në prezencën e Prokurorës së shtetit Dulina Hamiti, të akuzuarës N. E., mbrojtësit të saj sipas autorizimit, avokate M.S.E, të akuzuarit E.S, mbrojtësit të tij sipas autorizimit, avokat B. E, dëshmitarëve R. M, Xh.K, L. F dhe B .C pas shqyrtimit në bazë të nenit 366 të KPPK-së, në të njëjtën ditë, me datë **28.07.2016**, mori dhe publikisht në prezencën e palëve e shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

E akuzuara: **N .E.**, nga i ati H. dhe nënës E., e vajzërisë ., e lindur me *data e lindjes...*, në fshatin S., Komuna e P., ku dhe tani jeton në rrugën "...", pn., me numër personal *numer personal...*, ka të kryer Fakultetin e Farmacisë, e martuar, nënë e një fëmije, e gjendjes së mesme ekonomike, Shqiptare, shtetase e Republikës së Kosovës.

I akuzuari: **E. S.**, nga i ati F. dhe S., e vajzërisë Z., i lindur me *data e lindjes...* në Sh., me vendbanim në Gj., Rruga "... nr...", me numër personal *numri personal...*, ka të kryer Fakultetin Ekonomik, punon në Doganën e Kosovës, i martuar baba e dy fëmijëve, i gjendjes së mesme ekonomike, Shqiptar, shtetase e Republikës së Kosovës.

Në bazë të nenit 364, par. 1 nënpar. 1.3 të KPP të Republikës së Kosovës;

LIROHEN NGA AKUZA

Sepse:

I. E pandehura N. E., e punësuar në subjektin "... me numër të biznesit ... në P. në pozitën farmacistë, përgjegjëse dhe drejtuese teknike, ka vënë në qarkullim produkte të dëmshme mjekësore në atë mënyrë që më datën 03.05.2013, ka importuar produkte medicinale 1120 pako "... 160 mg suposte me numër serik 933012B me afat të skadimit 10/2014, në mënyrë të kundërligjshme pa u pajisur me licencë për import të serisë nga Agjencioni i Kosovës për Produkte Medicinale,-

- sepse nuk është provuar se e akuzuara e ka kryer veprën penale, Prodhimi dhe shpërndarje e produkteve të dëmshme mjekësore, nga neni 266 par.2 të KPRK-së.

II. I pandehuri E.S., në cilësinë e personit zyrtar derisa ka qenë duke punuar si doganier përgjegjës për ekzaminimin e ngarkesës dhe harmonizimin e dokumentacionit në terminalin doganor I. të D. me numër 6658 të datës 03.05.2013, i njëjti në momentin e zhdoganimit të produkteve të importuara nga subjekti “O. Ph.” nga Prishtina i ka mundësuar këtij subjekti që të bëjë zhdoganimin e mallit pa e poseduar dokumentacionin përkatës-licencën për import të serisë nga Agjencia e Kosovës për Produkte Medicinale-AKPM, i njëjti nuk e ka bërë harmonizimin e dokumentacionit me gjendjen faktike të mallit që është importuar pasi subjekti “O. Ph.” nuk ka pasur leje importi për produktin “...” 160 mg me numër serik 933012B me afat të skadimit 10/2014,-

- sepse nuk është provuar se i akuzuari e ka kryer veprën penale, Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar, nga neni 422 par.1 të KPRK-së.

-shpenzimet gjyqësore bien në barrë të mjeteve buxhetore, të kësaj gjykate.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë, Departamenti për Krime të Rënda, me aktakuzën PP/I.nr.1289/2013, të datës 25.04.2014, ka akuzuar, N. .E., për shkak të veprës penale, Prodhimi dhe shpërndarje e produkteve të dëmshme mjekësore, nga neni 266 par.2 të KPRK-së dhe E.S për shkak të veprës penale, Keqpërdorimi i pozitës apo autoritet zyrtar, nga neni 422 par.1 të KPRK-së.

Lidhur me këtë çështje gjykata ka caktuar dhe ka mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar ku menjëherë pas leximit të aktakuzës nga prokurorja e shtetit, të akuzuarëve iu dha mundësia e deklarimit të tyre lidhur me akuzën e cila u vihet në barrë, të njëjtit nuk e pranuan fajësinë për veprat penale, u deklaruan të pafajshëm dhe gjykata vazhdoi me shqyrtimin gjyqësor me radhën e paraqitjes së provave, me dëgjimin e dëshmitarëve dhe administrimin e provave materiale.

Prokurorja e shtetit në fjalën e saj përfundimtare deklaroi se mbetet në tërësi pranë aktakuzës kundër të akuzuarve N. .E. dhe E.S., për veprat penale si në aktakuzë, e që nga administrimi i provave dhe dëshmime gjatë shqyrtimit gjyqësor në mënyrë të padyshimtë dhe të plotë është vërtetuar se e akuzuara N. .E. ka kryer veprën penale, Prodhimi dhe shpërndarja e produkteve të dëmshme mjekësore, nga neni 266 par.2 të KPRK-së, ndërsa i akuzuari E.S. për veprën penale, Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar, nga neni 422 par.1 të KPRK-së, është vërtetuar edhe nga provat materiale, si procesverbali nga inspektoriat farmaceutik me numër serik 001000 të AKPM-së, vendimi nga Agjencioni i Kosovës për produkte medicinale si dhe nga provat e tjera të administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor, nga dëshmia e dëshmitarëve nga Inspektoriat Farmaceutik të AKPM-së. E akuzuara N. .E., ka importuar produkte medicinale të përshkuara si në dispozitivin e aktakuzës pa leje të importit për numër të serisë 933012B me afat të skadimit pa poseduar lejen e importit për këtë seri nga Agjencioni për produktet medicinale, ndërsa i akuzuari E.S ka mundësuar doganimin e këtij produkti medicinal pa e pasur lejen e importit për këtë numër të serisë nga Agjencioni për produkte medicinale, duke mundësuar që këto produkte e akuzuara t’i sjell në Kosovë pa lejen e importit, e sa i përket mbrojtjes së të akuzuarve të dhënë gjatë shqyrtimit gjyqësor e akuzuara është përgjigjur vetëm në pyetjet e mbrojtjes së saj, kurse në pyetje të prokurores është mbrojtur në heshtje, ndërsa gjatë deklaratës së dhënë në prokurori e ka pranuar se ka sjellur produktin medicinal “...” me numër serik 933012B pa e pasur lejen e importit nga Agjencioni për produkte medicinale, se ka bërë edhe shitjen e produktit “...” për serinë e lartcekur pa pasur lejen e importit për këtë numër të serisë, ndërsa i akuzuari Edmond nuk e ka bërë harmonizimin e mallit me gjendjen faktike të produktit medicinal që do të thotë pa e pasur lejen e importit të këtij produkti i njëjti e ka bërë zhdoganimin e mallit në terminalin doganor Intereuropa, i propozoj gjykatës që të njëjtit t’i shpall fajtor dhe ti dënoj sipas ligjit.

Mbrojtësja e të akuzuarës N. .E., av.M.S.E, në fjalën e saj përfundimtare deklaroi se baza juridike është e luhatshme andaj kjo çështje në aspektin juridik është lëshim administrativ e më tepër si e

tillë është “res judicata” dhe këtu nuk ka asgjë që të njëjtën mund ta kualifikonte si çështje penale. Povat në të cilat mbështetet aktakuza, nuk janë asgjë tjetër përveç një tregim dhe - apo tendence e paqartë për mbrojtjen, ashtu që një shkelje administrative të shëndërrohet në çështje penale që në praktikën e jurisprudencës së Kosovës është e pa zakonit për të mos thënë që nuk e ka gjetur askund. Dëshmitarët dhe procesverbalet e përpiluara dhe të nënshkruara nga organet kompetente kanë konstatuar se bari “...” suposte 160 mg është gjetur në zonën e karantinës, i pa kontrolluar që dëshmon se ky bar nuk ka dalë në qarkullim të lirshëm farmaceutik, si rrjedhojë del se këtu as që ka elemente të veprës penale, ngase bari nuk është vënë në qarkullim. Andaj i propozoj gjykatës që pas vlerësimit të provave të merr Aktgjykim lirues në mungesë të provave në përputhje me nenin 364 par.1 nënpar.1.1 dhe 1.3 të KPPK-së.

E akuzuara N. .E. në mbrojtjen e saj të dhënë gjatë shqyrtimit gjyqësor si dhe në fazën paraprake deklaroi, se ka punuar si përgjegjëse farmacistë në depon Farmaceutike në “O. Ph.”, në Prishtinë dhe si përgjegjëse kishte bërë kërkesën në Agjension e Kosovës për Produkte Medicinale (tutje AKPM), për furnizimin e depos me barna nga Shqipëria për 2400 copë ... suposte 160 mg dhe kishte marrë leje nga AKPM-ja, për importimin e atyre barnave me numër serik 131420C, dhe përmes email-it, menaxherja e deposë e kishte dërguar lejën e importit në T-Sh tek furnizuesi “O. G.”, dhe tek furnizuesi në Tiranë kishte ndodhur një gabim teknik, ku ngarkuesi nuk e kishte sasinë e duhur të mallit të porositur ... suposte me numër serik 131420C dhe për ta plotësuar sasinë ka ngarkuar vetëm 880 copë suposte ... me numrin serik 131420C, ndërsa pjesën tjetër në sasi prej 1120 me mallin e njejtë por me numër serik 933012B, ndryshe nga ai i porositur dhe për këtë ngarkesë furnizuesi nga Tirana nuk e kishte njoftuar se mallin e porositur në mungesë e kishte zavendësuar me seri tjetër. Me të pranuar mallin, meqë kishte edhe mall tjetër dhe nuk e kishte kontrolluar të tërin akoma por e kishte vendosur në depo, ndërkohë kishte shkuar inspeksioni të cilët me rastin e kontrollit i kishin kërkuar dokumentacionin e importit dhe kishin konstatuar serinë e ...susposte me seri tjetër nga ajo e porositur në Tiranë, për të cilën e kishte marre lejen nga AKPM-ja, dhe ia kanë ndërprerë shitjen e serisë 933012B, sasinë, prej 1120 copë për të cilën nuk e kishte lejën. E në këtë rast kishte ndodhe një gabim zingjiror, fillimisht në deponë O.G. në Tiranë, pastaj në Doganën e Kosovs. Për këtë gabim të ...suposte 160 mg me numër serik 933012B, me afat të skadencës 12.2014, O. Ph. është gjobitur në shumë prej 1500 € për shkak të pranimit të mallit në depo pa u kontrolluar se a është në rregull me numër serik dhe afat e skadencës, ngase në qdo import të produkteve medicinale është e nevojshme të bëhet kërkesa në AKPM për leje importi dhe në kërkesë duhet të ceket numri serik, data e skadencës dhe sasia e produktit medicinal, ndërsa në fjalën e saj përfundimtare, deklaroi se e mbështet në tërësi fjalën përfundimtare të mbrojtjes së saj.

Mbrojtësi i të akuzuarit E. S., av. B.E. në fjalën përfundimtare deklaroi se, prokuroria gjatë gjithë shqyrtimit gjyqësor nuk ofroi prova të cilat vërtetojnë dyshimin e bazuar mirë se E.S. ka kryer veprën penale si oficer doganor që është në kundërshtim me nenin 422 të KPK-së. Pas analizimit të provave të administruara që lidhur me E.S. ishin të pakta por shumë domethënëse, ku në bazë të dispozitivit të aktakuzës, prokuroria theksoi se E.S. i ka mundësuar “O. Ph.”-it që të importoj mall pa licencë, kjo fjali nuk doli se është siç pretendon prokuroria por e kundërta, ngase u administrua si provë licenca për import të produkteve medicinave, nga O. Ph., dhe se gjykata do tu besoj provave dhe jo fjalive. Është fakt i pamohueshëm se dëshmitari i propozuar nga ana e mbrojtjes si një punëtor me një përvojë më shumë se 15 vite në deklaratën e dhënë në cilësinë e dëshmitarit por edhe të përfaqësuesit të doganës z.B.C., deklaroi se DUD-i në shikim konform asaj që u pa ishte përpiluar në mënyrë të rregullt, dhe fjalia e dëshmitarit ishte shumë e qartë lidhur me atë se

E.S ka vepruar konform përshkrimit të vendit të punës por edhe kodit doganor dhe akcizave, gjithashtu autorizimi për kontroll pas importit të dt.20.05.2013, i nënshkruar nga shefi i sektorit pas importues z.Xh. F., për inspektoriatin e lartë D. K. dhe F.M. të cilët gjatë inspektimit së bashku me inspektorët e AKPM nuk kanë gjetur asnjë shkelje, dhe se sikur këta oficer doganorë

që kanë në kontroll po që se kishin hasur në një veprim apo mosveprim të E.S, më në asnjë mënyrë nuk do të ishte punëtor i stafit doganor, sepse kriteret dhe dicitinat janë në stadin më të lartë të mundshëm. Mbrojtja nuk e kishte të qartë si ka mundësi që dikush të akuzohet për keqpërdorim të pozitës apo autoritetit zyrtarë dhe të mos dihet pasoja, ngase janë dy çështje ose i ka shkaktuar dëm ose ka fituar pare dhe gjatë gjithë shqyrtimit gjyqësor nuk hasën në asnjë provë të vetme e cila do të vërtetonte se E si oficer doganor t'i ketë shkaktuar dëm "O. Ph." apo të ketë fituar para nga kjo. Andaj, në mungesë të provave me të cilat mund të vërtetohet dyshimi i bazuar mirë se E. S. ka kryer veprën penale e cila i vihet në barrë, se këtu ka të bëjë me një delikt administrativ nga ana e "O. Ph."-it për të cilën ka paguar gjobë siç u kuptua gjatë shqyrtimit gjyqësor, dhe se kjo çështje është e gjykuar siç është çështja administrative trupi gjykues të marrë një aktgjykim të drejtë, një aktgjykim lirues në mungesë të provave.

I akuzuari E.S, gjatë shqyrtimit gjyqësor e shfrytëzoi të drejtën e tij për tu mbrojtur në heshtje, ndërsa gjatë dhënies së mbrojtjes se tij në fazën paraprake deklaroi se punon si oficer doganor në sektorin e ekipit mobil të shiqimit në Doganë dhe mbulojnë të gjitha terminalet doganore, kontrollimin e mallit e bëjnë me sistemin e Doganës ACYCUDA, pastaj kontrolli bëhet në bazë të kriterëve sipas sistemit të doganës, kontrollohet sasia e mallit, lloji bazuar në dokumentacionin e ofruar dhe krahasuar me mallin fizikisht. Mallin e importuar për Kompaninë O. Ph. e kishte shikuar në bazë të kriterëve, ku ishte verifikuar lloji i mallit ...160 mg suposte dhe klasifikimi tarifor i mallit dhe gjendja faktike me atë të deklaruar në Dokument Unik Doganor (D.U.D), dhe detyra e tij si doganier ishte verifikimi i llojit të mallit, sasisë së mallit, klasifikimi tarifor si dhe të bashkangjitur edhe qertifikatën e AKPM-së dhe në ditën kritike kur edhe ishte bërë zhdoganimi i O. Ph. Grup shënimet ishin përputhur me faturën, deklaratën doganore dhe certifikatën e AKPM-së, sa i përket emërimit të mallit, vlerës dhe sasisë së mallit, ndërsa në fjalën e tij përfundimtare deklaroi se e mbështetë në tërësi fjalën përfundimtare të mbrojtësit të tij.

Dëshmitari R.M. në dëshminë e tij gjatë shqyrtimit gjyqësor deklaroi se punon në Institucionin – Agjencionin për Produkte Medicinale, të cilët bëjnë kontrollin e të gjitha subjekteve dhe produkteve që janë të licencuara apo që dëshirojnë të licencohen. Certifikatat për produktin, autorizimi për produktin që të regjistrohet në AKPM është për 5 vite dhe jepet për produktin në fjalë. Një produkt medicinal në AKPM së pari regjistrohet, e merr një licencë e ai produkt vetëm si produkt regjistrohet në AKPM edhe është valid për pesë vite. Në momentin që duhet bërë një import, kërkon nga prodhuesi apo përfaqësuesi i prodhuesit certifikatat e produktit që i ka në stok kudo që është dhe përfaqësuesi i prodhuesit, së pari i'a dorëzon certifikatat operatorit apo shpërndarësit për stokun që e ka atje dhe me ato certifikata vjen dhe aplikon në agjencion, e agjencioni konform atyre certifikatave lëshon një licencë për produktin në fjalë, prodhuesi apo i autorizuari për prodhuesin është i detyruar që të nisë produktin konform certifikatave. Certifikata është për një seri dhe secila seri ka certifikatën në vete përpos certifikatës gjenerale, lejohen të gjithë numrat serik dhe të gjitha llojet për kohëzgjatje të certifikatës së llojit të caktuar, certifikata për autorizim marketingu është certifikatë e cila lëshohet në bazë të zhvillimit dhe studimit të tërë dokumentacionit të produktit të prodhuar së bashku me të gjitha lejet që ai produkt i ka marrë në shtetin përkatës të nevojshme që produkti të mos jetë i rrezikshëm për qytetarët, nëse autoritetet Kosovare me këtë certifikatë kanë lejuar përdorimin e këtij bari në afat 5 vjeçar, rrjedh se ky bar nuk është i dëmshëm në përmbajtje e jo të serisë, dmth si produkt i ka kaluar të gjitha stadet që ai produkt të jetë i përgjegjshëm në tregun e Kosovës. Me rastet e

inspektimeve, kontrollohen subjektet dhe produktet dhe nëse gjejnë se ka shkelje apo konstatojnë se medikamenti është i dëmshëm për qytetarin, kanë të drejtë ta konfiskojmë e në rastin konkret në depon O. Ph. e kanë inspektuar dhe kanë hartuar një procesverbal të cilin e ka nënshkruar, dhe për barnat suposte ... deklaroi se nuk do të thotë që kanë qenë të rrezikshme, por kanë hasur në produkte në kundërshtim me praktitat e përgjithshme, ngase produktit i ka munguar leja e importit dhe certifikata për këtë numër serik ndërsa sasia ka qenë në rregull. Asnjë doganier nuk ka qenë i

specjalizuar për kontrollimin e barnave gjatë pikë kalimit në doganë dhe më tu paraqitur probleme të kësaj natyre që doganieret të akuzohen për mospërbushje të obligimeve të tyre të punës duke lejuar importet e barnave atëherë në marrëveshje me doganën, inspektorët janë lokuar nëpër pika doganore të autorizuara ngase duhet të plotësohen shumë kushte për të mundur të hapet bari dhe bërë kontrolli dhe verifikimi i produktit gjë të cilën doganierët me parë nuk e kanë pasur të drejtë, produkti medicinal duhet t'i plotësoj kushtet për hapjen e produktit duhet të jetë njeri profesionist dhe të kryej një sër shkollimi pasi që duhet ditur se si hapet një produkt medicinal dhe duhet të jetë njohës i praktikave të mira, i prodhimit dhe distribuimit dhe nuk janë të gjitha pikat doganore, por vetëm ato që i kanë plotësuar kushtet në pika të caktuara doganore prej nga bëhet verifikimi i produkteve konform lejes së importit pasi që produkti është i regjistruar dhe valid. Me datën 25.05.2013 ka bërë inspektimin në subjektin “O. Ph.” me rastin e kontrollit dhe perpilimit të procesverbalit nuk kanë konfiskuar produktet, ngase produktet konfiskohen vetëm kur janë kontrabanduara me qëllim jo penal, por për ruajtjen e pacientëve nga zingjiri i shpërndarjes në rrugë ilegale ngase dyshohet se mundet ta humb përmbajtjen e vetë, ndërsa në rastin kur produkti ka hyrë në rrugë legale por ka devijuar në ndonjë parametër të deklaratës së produktit e cila është certifikata, atëherë pala për neglizhencë apo pa përgjegjësinë e tij ndëshkohet. Produktin nuk e kanë ndal sepse është i keq por pse nuk i ka përmbushur kërkesat me numrin serik në certifikatë të cilin e kanë gjetur të pashitur në depo, në një vend ku nuk ka shkruajtur e ruajtur por nuk ka qene në farmaci ku janë të ekspozuar dhe shitur barnat, i cili produkt nuk është shpërndarë, ishte në një dhomë të veçantë të farmacisë e jo në pjesen ku shiten barnat. Në momentin që vie në depo çfardo defekti që posedon, personi përgjegjës e që është farmacisti për çdo gabim që e vëren parregullsinë e bën me procesverbal dhe e njofton prodhuesin dhe Agjencionin dhe nuk merr asnjë ndëshkim. Barit në fjalë i ka munguar vetëm numri serik në atë licencë të importit, nuk është deklaruar me shkrim si mall i tillë që të hynë e cila nuk ka leje që të hyjë në vend ndërsa doganohet me emër tjetër të serisë quhet i papërgjegjshëm, produkti në fjalë nuk e ka përmbushur çertifikatën për numrin serik të kërkuar, malli pa licencë nuk ka guxuar të hyjë në Kosovë pa licencën e mallit përkatës të cilën licencë është dashtë ta lëshoj AKPM-ja dhe se ky produkt nuk ka pasur leje për import të kësaj serie të këtij produkti. Produkti në fjalë ka pasur licencë dhe certifikatë dhe numër serik nuk ka pasur, ky produkt i ka plotësuar të gjitha kushtet por kjo leje importi i ka plotësuar të gjitha kushtet pos lejes së serisë së produktit e cila leja për import të produktit ...është lëshuar për një seri dhe në atë leje ka ardhur edhe seria tjetër, sasia nuk ka ndryshuar, sasia ka qene e njëjtë si në certifikatë, ky bar nuk ka pasur as banderolë dhe nuk ka mundur të del në treg pa banderolë pasi që secila banderolë që e lëshon agjencioni e ka të shënuar numrin serik të atij bari. Ndëshkimi nga Agjencioni ishte për shkak të papërgjegjësisë dhe vetëdijesimit për të ardhmen dhe është masë ndëshkuese lidhur me papërgjegjësinë e farmacistit e përcaktuar në udhëzimin administrativ ky ndëshkim.

Dëshmitarja L.F. gjatë dhënies se dëshmisë së saj gjatë shqyrtimit gjyqësor deklaroi se gjatë inspektimit të subjektit të “O. Ph.”, te e akuzuara N .E., ka qene në cilësinë e inspektorese bashku me kolegun R.M., në bazë të procesverbalit, kontrolli është bërë me kërkesë të policisë dhe është konstatuar se produkti “...” është me një numër tjetër serik me atë që është marrë leja e importit tek Agjencioni për të njëjtin produkt numri serik ka qene tjetër, për këtë seri të produktit që e kanë konstatuar nuk ka pasur leje importi, këtu është cek që kërkohet nga pala që këto produkte të ruhen gjer në urdhrin e ri. Në rastin e inspektimit të “O. Ph. “ produktin e kanë gjetur në depo. Secila përgjegjëse e depos ka për obligim që ta verifikoj

numrin serik të mallit të pranuar me atë të porositur për çka e ka edhe lejen e qarkullimit, në bazë të dokumentacionit ka vërejtur se depoja “O. Ph.” kanë sjell certifikatën e analizës për produktin “...” i cili ka qene i bllokuar në depo dhe është me rëndësi që dëshmon se produkti nuk ishte i rrezikshëm që e dëshmon atë numri serik.

Dëshmitari Xh. K. gjatë dhënies se dëshmisë së tij gjatë shqyrtimit gjyqësor ka deklaroi se Kodi Doganor është ligji bazë që rregullon procedurën doganore, gjithashtu vërteton se D.U.D-i me

nr.R6658 i datës 03.05.2013 është përpiluar konform dispozitave të kodit doganor, ka emrin e importuesit eksportuesit, numrin tarifor dhe llogaritjen e detyrimeve doganore. Fillimisht dokumentin unik doganor e plotëson përfaqësuesi i importuesit-shpediteri, pastaj i njëjti përmes mënyrës elektronike dorëzohet ose pranohet në doganën e Kosovës. Një DUD-ë mund të paraqitet vetëm me një faturë e cila është bazë për zhdoganimin e mallit pastaj dogana e merr dhe e trajton mallin në kuptimin doganor me të dhënat se a është import i rregullt varësisht nga regjimi doganor por në këtë rast kemi import të rregullt - IM4 e cila nënkupton importim të rregullt që duhet t'i nënshtrohet obligimeve doganore pastaj shikohet numri tarifor i cili determinon se a duhet të kërkohet për atë mall ndonjë leje e veçantë apo jo dhe pas kësaj merren llogaritjet e taksave doganore dhe i dorëzohet leje e veçante për marrjen e mallit një kopje të DUD të vulosur dhe të nënshkruar nga personi kompetent dhe pas pagimit të taksave doganore ai mall konsiderohet mall vendor, sipas meje malli për rastin konkret konsiderohet mall i importuar në mënyrë të rregullt.

Dëshmitari B.C. gjatë dhënies së dëshmisë së tij gjatë shqyrtimit gjyqësor deklaroi se DUD-i me numër R6658, është i nënshkruar në anën e djathtë të epërme nga kolegu i tij që nënkupton se ka harmonizuar të dhënat nga dokumenti unik doganor me dokumentacionin përcjellës siç janë fatura, licencat dhe dokumentet tjera pra kolegu guxon të nënshkruaj vetëm atëherë kur sigurohet se të dhënat e paraqitura në dokumentin unik doganor harmonizohen me dokumentacionin përcjellës në anën e poshtë të të njëjtit dokument, duket që janë dy nënshkrime që nënkupton se është ekzaminuar nga oficeri doganor dhe gjendja faktike e mallit përputhet me të dhënat në DUD-in. Malli i cili kalon nëpër терминаlet së pari duhet të kontrollohet nga inspektori i cili vjen nga MSH e që detyre e tij është të verifikoj se të dhënat të cilat gjenden në licencë a përputhen me gjendjen faktike, njësoj sikurse që e kanë obligim të harmonizojmë të dhënat në deklaratën unike doganore ashtu edhe inspektori e ka për obligim që të harmonizoj të dhënat që gjenden në licencën ose në lejen e importit të lëshuar në doganën e lartpërmendur. Në rastin kur konstatohet ndonjë parregullsi atëherë në bazë të nenit 82 të kodit doganor dhe të akcizave të Kosovës që e lejon auditimin që të bëjë këso kontrolla dhe varësisht nga gjendja e konstatuar i cili ka paraparë që për çdo parregullsi dhe varësisht nga natyra ndaj importuesit mund të udhëhiqet procedurë kundërvajtëse dhe nëse pësha e veprës është e rëndë procedurë penale, pasi që të dogana ka edhe hetues që merren me hetimin e rasteve, parashtrimin e kallëzimeve penale.

DUD-i përpilohet nga agjendi doganor dhe më pas kalon tek oficeri në pranim, barnat duhet të kenë patjetër licencën ose lejen për import ajo licencë duhet të kontrollohet prej inspektorit dhe për marrjen e licencës është kusht që të prezantohet certifikata e kualitetit të origjinës tek AKPM-ja, agjendi doganor e plotëson DUD-in dhe ia prezanton doganës së Kosovës, dogana e Kosovës e verifikon sasinë, çmimin, klasifikimin tarifor, peshën bruto dhe neto dhe licencën, licencën dhe lejen e importit nga AKPM-ja, për gjithçka dhe në bazë të DUD-it dhe asaj që pash është gjithçka në rregull, pasi që DUD-i është plotësuar në mënyrë të rregullt.

Rrjedhimisht trupi gjykues, pas shqyrtimit të deklaratave të dëshmitarëve dhe administrimit të provave materiale gjatë shqyrtimit gjyqësor, dëgjimit të mbrojtjes së të akuzuarve dhe pas vlerësimit të secilës provë një nga një dhe në lidhje reciproke me njëra tjetrën, komfor nenit 361 të KPP, vërtetoi gjendjen faktike si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nuk është aspak kontestuese fakti se e akuzuara N .E. është e punësuar në subjektin “O. Ph.” me nr. të biznesit ... në P. në pozitën farmacistë, përgjegjëse dhe drejtuese teknike dhe e njëjta i ka ndjekur të gjitha procedurat për të cilën ka bërë aplikimin për të marrë lejen e importit në AKPM dhe kishte marrë licencë për lejimin e importimit të llojit të barit ...160 mg supozitor, me autorizimin e marketingut nr.MA-0786/090911, e datës 09.09.2011, me afat pesë (5) vjeçar e vlefshme deri me 09.09.2016 e cila leje e importit është dhënë nga AKPM, me numër serik të caktuar dhe datën e skadencës dhe sasia e produktit medicinal me numër serik 131420C për 2400

copë ...suposte 160 mg dhe konform kësaj leje është dërguar kontingjenti i barërave për të cilën N .E. në emër të “O. Ph.”-it ka bërë kërkesë dhe për arsye teknike ka bërë devijim që në këtë kontingjent ka hyrë një sasi e caktuar e kutive të këtij bari jashtë numrit serik për të cilën ka pas leje nga AKPM-ja.

Po ashtu nuk është kontestues fakti se në mesin e sasisë së produkteve të porositura në O. G. në Tiranë dhe më pas edhe të importuar deri te shfytëzuesja O. Ph., janë gjetur sasia prej 1120 suposte ... 160 mg me numër tjetër serik 933012B, për të cilën numër serik e akuzuara nuk kishte leje për import të barit.

Sipas përshkrimit të veprimeve inkriminuese të të akuzuarës në dispozitivin e aktakuzës se “e akuzuara ka importuar produkte medicinale 1120 pako ... 160 mg suposte me numër serik 933012B me afat të skadimit 10/2014, në mënyrë të kundërligjshme pa u pajisur me licencë për import të serisë nga Agjensioni i Kosovës për Produkte Medicinale”, kjo nuk është vërtetuar ngase e akuzuara pas aplikimit në mënyrë të rregullt pranë AKPM-së, ka marrë leje importi nga Agjensioni për importimin e barit ... suposte me numër serik 131420C dhe për atë seri edhe kishte bërë kërkesën në Depon në Tiranë, e njëjta nuk e ka importuar produktin, përveq kërkesës që e ka parashtruar dhe më pas e ka bërë edhe pranimin e mallit në depon e tyre O. Ph. Në rastin konkret përgjegjësia - barra bie në ngarkuesin në Tiranë që me rastin e ngarkesës së mallit ia kishte plotësuar sasinë e barit ...suposte me numër tjetër serik e jo tërë sasinë për barin për të cilën kishte marrë edhe lejën për import dhe po ashtu edhe afatshmëria ishte më shumë se një vit prej kohës kur janë evidentuar në subjektin O. Ph. me datën 03.05.2015, por përgjegjësia e të akuzuarës bien në papërgjegjësinë e saj të mos kontrollimit me kohë me rastin e pranimit të mallit.

Po ashtu sipas përshkrimit të aktakuzës se e akuzuara si përgjegjëse dhe drejtuese teknike “Ka vënë në qarkullim produkte të dëmshme mjekësore“ edhe kjo sipas vlerësimit të gjykatës nuk qëndron ngase bari suposte ...sipas dëshmisë së dëshmiatarëve dhe bazuar edhe nga marrja e lejës së importit nga AKPM-ja, u konstatuar se ky bari nuk është i dëshmën dhe kishte akoma afat të vlershmërisë, dhe i njëjti bari nuk ishte vënë në qarkullim akoma, ngase është gjetur në depo, në karantinë e jo në vendin ku janë të ekspozuara barnat.

Kjo gjendje faktike është vërtetuar nga dëshmia e dëshmiatarëve R.M dhe L.F, inspektor nga Agjensioni Kosovar për Produkte Mediocionale, të cilët e kishin inspektuar subjektin në fjalë dhe kishin konstatuar të gjeturat lidhur kontrollimin.

Sipas dëshmisë së dëshmiatarit e të cilën gjykata e vlerësoi reale dhe ia fali besimin, bari suposte OKI, nuk ishte bari i dëmshëm dhe me rastin e kontrollimit të subjektit nuk ishte konfiskuar dhe se vetëm në rastet kur malli është i dëmshëm apo i kontarbanduar ai mall konfiskohet ndërsa në rastin konkret ai mall ishte importuar në mënyrë legale por produkti me numër tjetër serik për të cilin subjekti nuk kishte leje importi i cili mall ishte gjetur në depo, akoma pa u vu në qarkullim dhe pa banderola, e që pa banderola të cilat duhet ta kenë edhe numrin serik nuk mund të vihen në qarkullim, e njësoj dëshmoi edhe dëshmiatarja L.F., se produktin e kishin gjetur në depo akoma pa u vu në shitje e jo në barnatore.

Se bari akoma ishte në depo këtë e dëshmoi edhe vet e akuzuara në mbrojtjen e saj se akoma nuk kishte arritur që ta bënte kontrollimin e tërë mallit të porositur nga Tirana, ngase në mesin e barnave përveq suposteve ... kishte edhe barna tjera, po ashtu e njëjta nuk ishte informuar nga ngarkuesi në Tiranë për plotësimin e një sasive të barnave me numër tjetër serik, dhe me të pranuar mallin nuk e kishte vërejtur se numri serik i një sasive të barnave nuk përputhej me numrin serik për të cilën ishte marrë leje nga AKPM-ja.

Se e njëjta nuk kishte qenë e vëmendshme dhe për shkak të papërgjegjësisë me rastin e pranimit të mallit dhe të mos verifikimit me kohë me qëllim të kthimit të mallit drejt origjinës e më pas ta

kërkojë leje importin për atë numër serik, ishte ndëshkuar me gjobë administrative në vlerë prej 1500 eruo të cilën e ka paguar me 10.06.2013 në R Bank.

Gjykata ia fali besimin mbrojtjes së saj dhe mbrojtja e saj korrespondoj edhe me dëshmine e dëshmitarëve dhe me provat e tjera materiale ngase bari ... suposte nuk ishte një barë i dëshmën dhe i rrezikshëm, por vetëm për faktin se për atë numër serik nuk kishte leje importi, nuk ishte vu akoma në qarkullim ngase ishte ne depo, kishte akoma afatshmëri.

Sa i përket të akuzuarit E.S., nuk është aspak kontestuese fakti se i akuzuari E.S., në cilësinë e personit zyrtar i punësuar si doganier përgjegjës për ekzaminimin e ngarkesës dhe harmonizimin e dokumentacionit në terminalin doganor I .E. Kjo gjendje faktike u vërtetua edhe nga mbrojtja e tij i cili ka sqaruar se punon në terminalin doganor dhe me datën 03.05.2013, ishte në detyrën e tij zyrtare dhe konfirmoi edhe me nënshkrimin e tij në Dokumentin Unik Doganor (tutje DUD), me numër serik 6658 të dt.03.05.2013.

Po ashtu nuk kontestues as fakti se i njëjti e kishte bërë zhdoganimin e mallit –produkteve të importuara nga subjekti O. G., e kishte plotësuar DUD, me shënimet të cilat ishin përputhur me certifikatën e AKPM-së, sa i përket emërtimit të mallit, vlerës dhe sasisë.

Po ashtu se i njëjti kishte vepruar konform ligjit dhe procedurave doganore këtë e dëshmuar edhe dëshmitarët të cilët sqaruar edhe C. edhe Xh. se DUD, në shikim si dokument është në rregull dhe në përputhje më të gjitha standardet dhe në bazë të përshkrimit të të dhënave në atë dokument mund të bëhet edhe zhdoganimi i mallit.

Sipas dëshmisë së dëshmiatërit R.M., i cili sqaroi se për të qenë ekspert dhe për verifikimin në detaje të mallrave (barnave), janë persona të specializuar të cilët mund të bëjnë hapjen e barnave dhe kontrollimin e tyre, por ky rregull ishte bërë vetëm pasi janë ngitur akuza dhe janë bërë hetime për zyrtarët doganor, dhe nga Agjensionit tani janë vendosur persona të specializuar në pika të caktuara doganore të cilët e bëjnë verifikimin e barnave dhe në përputhje me harmonizimin me dokumentacionin përkartës, dhe në rastin konkret personi zyrtar tani i akuzuari E.S në kohen kur është akuzuar nuk ka qenë person i specializuar nga Agjensionit i cili mundet që ta bëjë verifikimin në detaje se a përputhet malli i sjellur në dogane me të gjitha dokumntacionin mbështetës edhe pse në shikim të parë ka rezultuar se ka qenë në rregull por këto arsye e kanë bërë bërë përzgjedhja e personave të specializuar për zhdoganimin e barnave.

Po ashtu gjykata ua fali besimin në tërësi mbrojtjes së dhënë nga i akuzuari dhe dëshmisë së dëshmitarëve të cilat u përputhen më njëra tjetrën se edhe dëshmitarët deklaruan me rastin e ofrimit në shikim të dud-it, se ky dokument është i plotësuar në mënyrë të rregullt dhe në të janë të përshkruara të gjitha shënimet të cilat e bëjnë të vlefshën një dokument të tillë.

Po ashtu se i njëjti nuk e ka keqpërdoruar detyrën e tij zyrtare kjo për faktin se prokuroria e shtetit gjatë shqyrtimit gjyqësor nuk arriti ta argumentoj më asnjë provë të vetme se qfarë përfitoi i akuzuari me veprimet e tij për vete apo për tjetrin. Nuk ishte i akuzuari E. që i shkaktoi dëm të akuzuarës N. duke e bërë zhdoganimin e mallit, ngase edhe vet e akuzuara edhe pse ishte përgjegjëse farmacistë nuk e kishte vërejtur me kohë se një sasi e barnave nuk korrespodonte me numrin serik të porositur e për të cilin posedonte leje, e si do ta dinte i akuzuari kur i njëjti nuk është më profesion farmacist por u besoi letrave të cilat ishin bashkangjitur mallit në Doganë.

Duke pasur parasysh elementet qenësore të veprës penale, Keqpërdorimi i pozitës apo autoritet zyrtar që primare për të ekzistuar kjo vepër duhet te jetë elementi volutiv apo dashja si element subjektiv i kësaj vepre penale dhe gjykata ka vërtetuar se në rastin konkret mungon dashja direkte e të akuzuarit E.S. e që kjo formë e veprës penale manifestohet jo vetëm në pasojat materiale që rezultojnë nga kryerja e veprës penale por sidomos në rrënimin dhe çrregullimin e rrjedhave themelore të jetës shoqërore duke atakuar vlerat morale dhe shoqërinë.

Elementet qenësore të kësaj vepre penale, siç është Keqpërdorimi i pozitës apo autoritet zyrtar përmes shfytëzimit të kundërligjshëm të pozitës apo autorizimit me qëllim të përfitimit të çfarëdo

dobie për vete apo për personin tjetër apo t'i shkaktoj dëm personit tjetër ose që seriozisht t'i shkel detyrat që janë në kompetencë që personi zyrtar t'i aplikoj me rastin e zabtimit të detyrave përgjegjëse gjykata nuk i ka vërtetuar asnjë nga këto elemente në veprimet e të akuzuarit, ngase prokuroria e shtetit nuk ka arritur që të argumnetojë para gjykatës që i akuzuari E.S. duke e keqpërdorur detyrën e tij zyrtare ka përfitur qfarëdo dobie pasurore në mënyrë të kundërligjshme për vete apo për personin tjetër apo t'i ketë shkakuar dëm personit tjetër dhe dashja si element kryesor nuk konsumohet në veprimet e tij. Po ashtu si keqpërdorim të kësaj natyre përcaktohet veprimi i caktuar dhe qëllimi i caktuar dhe se nuk mund të jetë edhe çdo keqpërdorim patjetër edhe vepër penale e në rastin konkret mund të kete karakter të përgjegjësisë disiplinore edhe pse gjykata për të akuzuarin E nuk ka asnjë fakt se Dogana e Kosovës të ketë marrë ndonjë masë disiplinore kundër të akuzuarit, ndërsa për të akuzuarën N. .E. mund të kete përgjegjësi tjetër por jo edhe vepër penale dhe gjykata e vlerësoi se e njëjta për shkak të papërgjegjësisë së saj është ndëshkuar nga AKPM-ja me gjobë administrative e që gjykata e vlerësoi se ky rast në këtë qështje vlerësohet si çështje e gjykuar apo “res judicata”.

Prokuroria nuk arriti që t'i argumentoj me fakte dhe prova para gjykatës elementet e veprës penale me të cilën ngarkohen të akuzuarit ngase nga provat e administruara nuk gjeti se në veprimet e të akuzuarve formësohen elementet qenësore subjektive dhe objektive të veprave penale, e që e përbëjnë figurën e veprave penale, Prodhimi dhe shpërndarja e produkteve të dëmshme mjekësore, nga neni 266 par.2 të KPRK-së për të akuzuarën N. .E. dhe Keqpërdorimi i detyrës apo autoritet zyrtar, nga neni 422 par.1 të KPRK-së, për të akuzuarin E.S., për të cilën të akuzuarit akuzoheshin, andaj nisur nga të gjitha këto që u thanë trupi gjykues pasi analizoi dhe vlerësoi provat e administruara, dëshmitë e dëshmiatrëve dhe mbrojtën e të akuzuarve, nuk gjeti se në veprimet e të akuzuarëve N. .E. dhe E.S. formësohen elementet e veprave penale të lartcekura, dhe në mungese te provave dhe mos ekzistimit te elementeve të veprave penale, konform neni 364 par.1 nënpar.1.3 të KPPK-së, të akuzuarit i liroi nga akuza.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale dhe paushallit gjyqësor, është marrë në bazë të nenit 454, par. 1, të KPPK.

Palë të dëmtuar në këtë çështje penale nuk ka pasur të propozuar nga prokuroria e shtetit.

Nga sa u tha më lart, në kuptim të nenit 364 par.1 nënpar.1.3 të KPPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA
PKR.nr.227/14, datë 28.07.2016

Sekretarja juridike
Arbnore Idrizi

Kryetarja e trupit gjykues
Valbona Musliu-Selimaj

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë në afat prej pesëmbëdhjetë ditësh nga data e marrjes së vendimit per Gjykatën e Apelit përmes kësaj gjykate.